



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.10, datë 27.02.2019

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“DEPOZITA BREGDETARE ME KAPACITET 3 X 10 000 M³, NE ZONËN
ENERGJETIKE DHE INDUSTRIALE TË PORTO ROMANOS, BASHKIA DURRËS”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Royal Trade Company” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Depozita Bregdetare me kapacitet 3 x 10 000 m³, ne zonën energjetike dhe industriale të Porto Romanos, Bashkia Durrës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Royal Trade Company” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



A circular official stamp in blue ink. The outer ring contains the text "REPUBLIKAE SHQIPERISE" at the top, "MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" on the sides, and "TIRANE" at the bottom. In the center is the coat of arms of Albania.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA



A circular official stamp in blue ink. The outer ring contains the text "REPUBLIKAE SHQIPERISE" at the top, "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT" on the sides, and "MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" at the bottom. In the center is the coat of arms of Albania.